

# NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NËXTJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDRËVEPRIMIT ME TË OJITHË SHQIPTARËT,  
DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#15

## Mbledhja e radhës e Komitetit Shtetëror për Diasporën

Sot u mbajti takimi i radhës i Komitetit Shtetëror për Diasporën, ku ministri i Shtetit për Diasporën prezantoi ecuritë e ndërimit të strukturës shtetërore përfshirë aktivitetin e deritanishëm të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit të Zhvillimit të Diasporës dhe Qendrës e Botimeve për Diasporën. Gjatë takimit të sotëm u prezantuan edhe koordinatorët shtetërorë: Koordinatori Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptar jashtë vendit, zv.ministri për Europën dhe Punët e Jashtme z. Etien Xhafaj, Koordinatori Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën shqiptare, zv. e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi;

Koordinatori shtetëror për informimin e diasporës: Z. Faqon Halikaj ( A K SH I); Koordinatori shtetëror për programet/donorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, zv.ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino si dhe Koordinatori Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtit të automjeleve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, zv.ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, z.Artan Shkrelli. Secili koordinator njohu anëtarët e komitetit me punën e realizuar si dhe objektivat e ardhshme



## Ministri i Shtetit për Diasporën në ceremoninë e prezantimit të “Lufthansa Industry Solution”



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandell Majko mori pjesë në ceremoninë e prezantimit të “Lufthansa Industry Solution”, pjesë e grupit gjerman “Lufthansa”. Në fjalën e tij përshëndetëse ministri u shpreh se ky lloj investimi në Shqipëri është një ngjarje e veçantë. “Ky është një realitet i ri, fakti i kërkesave të brezit të ri në Shqipëri, sidomos për këto kategoritë investimesh. Sot, ka qindra studentë shqiptarë të cilët studiojnë në universitete më të mira dhe ky fakt krijon një standard të ri në shoqërinë shqiptare”, tha ministri. “Lufthansa industry Solution”, është një ofrues shërbimi për IT konsultime dhe integrimin e sistemeve. Kjo degë e sapokrijuar në Shqipëri do të ofrojë shërbim për transformimin digital të kompanive të tyre.

## Drejtoresha e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës takohet me zv.ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në Kosovë



Drejtoresha e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës znj. Soana Jaupllari takohet me zv.ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në Kosovë, z. Isni Klleç. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i përvojave mes dy institucioneve që lidhen me Diasporën. Znj. Jaupllari, e ka përgëzuar Ministrinë e Diasporës për punën e bërë në gjithë këto vite, veçanërisht për regjistrimin e Diasporës. Gjithashtu informoi z. Klleç edhe për punën dhe projektet që bën Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Zv. ministri Klleç foli për projektet e veçanta të Ministrisë së Diasporës, përmes të cilave i ofrojnë mbështetje mërgatës kosovare.



## Drejtoresha e Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës takohet me drejtorin ekzekutiv të “Innovation Centre Kosovo”

Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, drejtoresha e Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, znj. Soana Jaupllari zhvilloi një vizitë pune në Kosovë, ku u takua me drejtorin ekzekutiv të “Innovation Centre Kosovo”, (ICK) z. Uranik Begu. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i eksperiencave dypalëshe, identifikimi i praktikave më të mira për arritjen e objektivave të projektit dhe nxitjen e angazhimit të Diasporës në përgjithësi, pasi ajo vazhdon të mbetet një ndër kontribuesit më të mëdhenj në zhvillimin e Shqipërisë dhe Kosovës.

Znj. Jaupllari e njohu z. Begu me institucionin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, praktikën e tij, si dhe projektin “Diaspora për Zhvillim”. Gjithashtu, u ndal edhe të synimi për realizimin e projekteve të ardhshme dhe mundësitë e bashkëpunimit. Ndërsa z. Begu e njohu me projektet, bizneset start-up të zhvilluara në këtë qendër, kapacitetet dhe arritjet e kësaj qendre.

### PYETËSORI E DIASPORËS



Me qëllim konvertimin në format digital të veprave të zgjedhura shqiptare, si pjesë e projektit “Diaspora për Zhvillim” Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka realizuar pyetësori e diaspora. Qëllimi i tij është mbledhja e informacionit në lidhje me titujt që publiku preferon, për të mundësuar më tej konvertimin e tyre në format digital. Pyetësorin mund ta plotësoni këtu:  
<https://www.adfd.al/pyetesori-e-diaspora/>

### FSHZHD takim me organizatën “Germin”



Drejtoresha e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës znj. Soana Jaupllari zhvilloi një takim me përfaqësuesit e organizatës “Germin” në Kosovë. Takimi u fokusua në eksperiencat dypalëshe në identifikimin e praktikave më të mira për arritjen e objektivave të projektit dhe nxitjen e angazhimit të Diasporës në përgjithësi.